

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Letër nga Uashingtoni: I vënë në vështirësi, Trump i kthehet taktikave ballkanike
ADRESA	https://www.reporter.al/2026/09/29/leter-nga-uashingtoni-i-vene-ne-veshtiresi-trump-i-kt-hehet-taktikave-ballkanike/
BURIMI	reporter.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	29 shtator 2026, 09:11:08 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 1800 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	29 shtator 2026, 09:10:32 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e46f1f6e2b1214baee0205eb472fe22adf17a17b429218404f21f1d41facf44c
TEKSTI	3ac637fd9ca475ecb131af74b023d37416318e94ecbb930a7123c25e3deecaad
PAMJA	c57083f757ac26f88184887d2f4a0c5ba4c4575b696ba45ba5ca5dce3cdbb8f8

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	937477dea73b3c10ceb26db39d73bd438bd40c951ae4760220d0d2172fd98be6
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	5542c6f376d7530e05241a95b291e64e02f5f89d799222f37a26423635f8fe31
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/937477dea73b3c10ceb26db39d73bd438bd40c951ae4760220d0d2172fd98be6>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Kryefaqja Opinion

Letër nga Uashingtoni: I vënë në vështirësi, Trump i kthehet taktikave ballkanike

Me afrimin e zgjedhjeve të mesmandatit dhe teksa sondazhet nuk po duken aspak mirë, administrata amerikane duket se po mendon për dhurata elektorale të stilit ballkanik – ndërsa njëkohësisht u toleron hapësirë atyre që po zhbëjnë demokracinë dhe mohojnë krimet e luftës.

nga Jovana Djurovic — 14 seconds më parë në Opinion Koha e leximit: 8 min lexim

AA 0



Presidenti amerikan Donald Trump. Foto: Wikipedia.

Përsëritje nga Bregu Lindor, ku ky muaj ka qenë veçanërisht i ngarkuar – nga mbledhja vjetore e liderëve botërorë në Asamblesë të Përgjithshme të OKB-së në Nju Jork, ku secili ka mundësinë të dalë në fotografi dhe të ketë skenën e vet për të shpalosur ankesat (për publikun në vendin e vet), te takimi zyrtar i presidentit kinez Xi Jinping me Donald Trump në Uashington – një vizitë që, ashtu si edhe UNGA-ja, ishte e mbushur me pompozitet dhe e varfër në rezultate konkrete.

Në planin e brendshëm, zgjedhjet e mesmandatit po afrohen dhe fushata po nis të ngjajë gjithnjë e më shumë me ato që njohim nga Ballkani. Trump po e përshkallëzon përplasjen me mediat që e kritikojnë, ndërsa, teksa një tjetër luftë, ajo në Iran, po e bën Trump-in edhe më jopopullor, ai po i rikthehet një tjetër truku politik ballkanik: kur gjërat vështirësohen, shpërnda nga paratë e taksapaguesve!

Trump ka premtuar se, nëse republikanët ruajnë shumicën në Kongres, çdo i rritur amerikan do të marrë 5,000 dollarë. Megjithatë, një masë e tillë do të duhej të merrte dritën jeshile në Capitol Hill, ndaj është ende larg të qenit e sigurt se amerikanët do t'i marrin vërtet këto para – ndryshe nga Serbia, ku presidenti në largim shpërndan para nga buxheti i shtetit në prag të zgjedhjeve, pavarësisht se nuk ka autoritet ta bëjë një gjë të tillë.

Ndërsa taktikat e stilit ballkanik po shfaqen gjithnjë e më shumë në politikën amerikane, administrata Trump vazhdon të përqendrohet në avancimin e interesave të veta, duke mbyllur sytë ndaj erozionit të demokracisë dhe rikthimit të së kaluarës së viteve '90 në Ballkan.

Kjo u konfirmua deri diku edhe nga sekretari amerikan i Shtetit, Marco Rubio, në deklaratat e tij në margjinat e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, kur tha se, ndonëse Serbia mund të jetë "e përfshirë në disa çështje që janë potencialisht problematike dhe shpërthyes" dhe që përbëjnë shqetësim ndërkombëtar, Shtetet e Bashkuara duan të thellojnë partneritetin e tyre strategjik me shtetin ballkanik.

Heshtje për Dodikun – dhe Mlladiçin

Në fillim të këtij muaji, zv/ndihmëssekretari i Shtetit Daniel Lawton informoi anëtarët e

Letër nga Uashingtoni: I vënë në vështirësi, Trump i kthehet taktikave ballkanike

11:10 | 29/09/2026

Jo vetëm Kushner: Tre resorte të tjera po projektohen në zonën e mbrojtur të Zvërnecit

07:26 | 29/09/2026

Këshilli i Sigurisë përforcon alibinë e Ramës për Vlora Hysenin

17:09 | 28/09/2026

Iluzioni i bumit të produktivitetit nga IA-ja

14:20 | 28/09/2026

Industria nxjerrëse në Shqipëri shënoi turrje gjatë vitit 2025

12:57 | 28/09/2026

Një klimë, mijëra lekë: Si po bien shqiptarët në grepin e 'mashtimit kompjuterik'

07:59 | 28/09/2026

Kongresit mbi politikën e SHBA-së në rajon, gjatë një seance dëgjimore para Komisionit të Dhomës së Përfaqësuesve për Punët e Jashtme.

Ndërsa Lawton përsëriti se prioritetet janë stabiliteti (duke shpërfillur paqëndrueshmëritë e brendshme), avancimi i interesave tregtare të SHBA-së dhe lufta kundër kimit të organizuar, anëtarët e Kongresit ngritën disa pyetje të vështira. Të dyja partitë dukeshin të shqetësuara për të njëjtat çështje: Pse SHBA-ja nisi një dialog strategjik me Serbinë, ndërkohë që Beogradi po forcon lidhjet me Rusinë dhe Kinën? Pse u hoqën sanksionet ndaj ish-udhëheqës të serbëve të Bosnjës, Milorad Dodik, nëse ai nuk hoqi dorë nga retorika e tij separatiste? A do të rrezikohet paqja në Kosovë nëse administrata zbaton synimin e saj për të reduktuar numrin e amerikanëve në misionin paqeruajtës të udhëhequr nga NATO-ja, KFOR?

Përgjigjet ishin të paqarta. Lawton tha se SHBA-ja dëshiron të jetë "partneri i preferuar" i Serbisë, edhe pse kompania energjetike serbe NIS vijon të jetë në pronësi ruse dhe Beogradi po blen armë dhe teknologji kineze. Ai shmangu një përgjigje të drejtpërdrejtë nëse do të mbështeste rikthimin e sanksioneve ndaj Dodikut për shkak të retorikës së tij të pandryshuar dhe lidhjeve të ngushta me Moskën, një çështje që u ngrit me këmbëngulje nga kongresmeni demokrat William Keating.

Kongresmeni paraqiti një raport, "Pay for Play", që dokumenton se si lobimi intensiv i Dodikut me kompani të lidhura me Trump-in çoi në heqjen e sanksioneve ndaj tij, si dhe se si një kompani e lidhur me presidentin amerikan mori kontratën për të qenë operatori kryesor i gazsjellësit të Interkoneksionit Jugor në Bosnje. Lawton nuk komentoi mbi këto gjetje, por përsëriti se KFOR-i mbetet jetik për ruajtjen e paqes në Kosovë. Asgjë e re këtu.

Megjithatë, po të mos ishte kjo seancë dëgjimore, ndoshta nuk do ta kishim mësuar kurrë se çfarë mendon administrata Trump për nderimet e bëra në funeralin e ish-komandantit të serbëve të Bosnjës, Ratko Mlladiç, i cili u dënua për gjenocid në Srebrenicë.

Departamenti i Shtetit ka heshtur për këtë çështje, ndryshe nga një grup i vogël kongresmenësh që e përshkruan sjelljen e autoriteteve serbe gjatë funeralit si "thellësisht shqetësuese". I pyetur nga një kongresmene demokrate nga Nevada, Lawton këmbënguli se SHBA-ja gjithashtu kundërshton glorifikimin e kriminelëve të luftës dhe se tragjeditë e krimit e viteve '90 nuk duhet të shndërrohen në teatër politik.

Duke pasur parasysh situatën në terren, ku si Serbia, ashtu edhe Bosnja e Hercegovina janë zhytur në fushata zgjedhore, një deklaratë e tillë nga Uashingtoni ishte e vonuar prej kohësh. Heshtja ka favorizuar presidentin serb në largim, Aleksandër Vuçiç, i cili i tha CNN-it se nuk mori pjesë në funeralin e Mlladiçit, por se ai ishte funerali më i madh i 50 viteve të fundit. Me fjalë të tjera, ai, Vuçiç, mbetet basti më i sigurt i Perëndimit.

Nga ana tjetër, reagimi ndaj vendimit të Hagës që dënoi ish-presidentin e Kosovës Hashim Thaçi, i cili u shpall fajtor për krime lufte, ishte i menjëhershëm. Po atë ditë, Departamenti i Shtetit publikoi një deklaratë ku tha se SHBA-ja respekton vendimin e Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe bëri thirrje për përmbajtje në retorikë.

Kontradiktat rreth vendimit për Thaçin

Por qëndrimi i Uashingtonit për këtë çështje përmban një kontradiktë të dukshme. Richard Grenell, i dërguari i posaçëm i Trump-it për misionet speciale (dhe ish-i dërguari për procesin e dialogut Kosovë-Serbi), e quajti vendimin "skandaloz" dhe i përshkroi gjyqtarët dhe prokurorët si "të marrë të majtë".

Grenell e ka mbrojtur prej kohësh Thaçin dhe ka kritikuar ashpër prokurorin Jack Smith, i cili ngriti aktakuzën ndaj ish-presidentit të Kosovës. Grenell pretendon se, duke vepruar kështu, Smith shkatërroi një fitore të mundshme diplomatike të Trump-it, pasi, sipas tij, Thaçi ishte nisur drejt Uashingtonit në qershor 2020 për të nënshkruar një marrëveshje normalizimi me Serbinë, por u kthye menjëherë në Kosovë sapo u bë publike aktakuza.

Smith është gjithashtu në shënjestër sepse, pasi u emërua prokuror i posaçëm në Departamentin amerikan të Drejtësisë, ngriti dy aktakuza ndaj Trump-it – të cilat u pushuan pasi Trump u rizgjodh. Grenell e di mirë se Trump nuk i harron ata që i kanë dalë kundër në të kaluarën dhe se sulmet publike ndaj kundërshtarëve të presidentit janë një mënyrë e mirë për të dëshmuar besnikëri – diçka që Trump e vlerëson veçanërisht.

Megjithëse administrata Trump, që prej marrjes së detyrës, nuk ka reaguar asnjëherë ndaj zhvillimeve të brendshme në Serbi, çështja doli në qendër të vëmendjes falë kongresmenit Joe Wilson nga Karolina e Jugut, i cili paraqiti aktin "Supporting the Rule of Law, Building Institutional Justice, and Accountability" ("SRBIJA").

Pavarësisht se është anëtar i Partisë Republikane dhe ka mbështetjen e Trump-it për rizgjedhjen e tij këtë nëntor, Wilson po sfidon politikën e administratës me këtë projektligj, i cili kërkon që SHBA-ja të pezullojë dialogun strategjik nëse nuk trajtohen çështjet që lidhen me zgjedhjet e lira dhe të ndershme, si dhe forcimin e lidhjeve me Rusinë, Kinën dhe Iranin. Propozimi gëzon mbështetje dypartiake, çka lë të kuptohet për një dakordësi më të gjerë mbi

objektivin strategjik: një vend me të cilin Amerika bashkëpunon duhet të jetë i orientuar drejt Perëndimit dhe të ketë një qeveri të zgjedhur në mënyrë legjitime.

Wilson nuk u ndal te projektligji. Ai ka vazhduar ta kritikojë presidentin Vuçiç pothuajse çdo ditë dhe ka lënë në kuptohet se do të manipulojë zgjedhjet e parakohshme në Serbi, më 25 tetor, duke përdorur modele të aplikuara nga presidenti rus Vladimir Putin. Dega ekzekutive, megjithatë, duket e pashqetësuar nga këto akuza, ndërsa Departamenti i Shtetit ka thënë se po "monitoron nga afër përgatitjet për zgjedhjet".

Pas zgjedhjeve të fundit parlamentare në Serbi, në dhjetor 2023, të cilat vëzhguesit ndërkombëtarë thanë se u shoqëruan me parregullsi, SHBA-ja dhe BE-ja i bënë thirrje së bashku Beogradit që të punonte për zbatimin e rekomandimeve të misionit vëzhgues të Zyrës së OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut. Është e vështirë të imagjinohej që Uashingtoni të dërgojë një mesazh të ngjashëm këtë herë.

Ndërkohë, në Senat u zhvillua një seancë dëgjimore për kandidatët e propozuar për ambasadorë në Serbi dhe Bosnje e Hercegovinë. Profesori i së drejtës Michael Young, i nominuar për Serbinë, dhe gjenerali në pension Ronald Johnson, i nominuar për Bosnjën, paraqitën vizionet e tyre për misionet përkatëse dhe iu përgjigjën pyetjeve të senatorëve.

Të dy konfirmuan se do të punonin mbi prioritetet e njohura të administratës Trump në rajon dhe treguan se synojnë t'i shërbejnë presidentit në mënyrë të kënaqshme. Senatori demokrat Chris Murphy bëri një pyetje të sikletshme: A do të ndihmonin ata një anëtar të familjes së Trump-it të promovonte investimin e tij privat, nëse ky investim do t'i sillte një përfitim të drejtpërdrejtë financiar familjes së presidentit? Si Young, ashtu edhe Johnson u përgjigjën se e konsideronin detyrë të tyre të promovonin të gjitha investimet amerikane gjatë kohës që shërbenin si ambasadorë.

Në fund të këtij debati, Murphy, disi i irrituar, tha: "Zotërinj, përgjigjja është jo! Nuk është e përshtatshme që ambasadori të llobojë në favor të projekteve që do ta pasurojnë presidentin ose familjen e tij. Kjo është një përgjigje e thjeshtë!"

Duke folur për projektet e familjes Trump në rajon, protestat kundër ndërtimit të një kompleksi luksoz turistik nga dhëndri i Trumpit, Jared Kushner, kanë vazhduar në Shqipëri. Por kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, dorëheqjen e të cilit po e kërkojnë protestuesit, vazhdon ta mbrojë Kushner-in dhe pretendon se resorti do t'u sjellë përfitime qytetarëve shqiptarë.

Investimet amerikane u diskutuan gjithashtu nga ministri i Jashtëm shqiptar, Ferit Hoxha, dhe i dërguari i posaçëm i Trump-it për Partneritetet Globale, Paolo Zampolli, i cili vizitoi Tiranën këtë muaj. Zampolli konsiderohet një ndërmjetës jozyrtar për marrëveshjet e administratës Trump. Dikur ai u mburr se i kishte shitur Uzbekistanit "20 miliardë dollarë avionë Boeing për 20 minuta". Së fundmi, ai publikoi në Instagram se po "shet astronautë" dhe se vendet nënshkruese të Marrëveshjeve Artemis do të kenë mundësinë të dërgojnë astronautët e tyre në hapësirë së bashku me homologët amerikanë.

Shqipëria nënshkroi së fundmi Marrëveshjet Artemis. Më herët, Serbia ishte i vetmi vend tjetër ballkanik që e kishte nënshkruar marrëveshjen. Ende nuk është e qartë se sa do të kushtojë kjo.

Ndërsa shet projekte të përbashkëta në hapësirë, këtu në Tokë Uashingtoni po shkurton ndihmat edhe për vendet që kanë nisur procese të "dialogut strategjik" me SHBA-në. Maqedonia e Veriut ishte ndër katër vendet evropiane për të cilat SHBA-ja planifikon të shkurtojë ndihmën ushtarake me një total prej 52 milionë dollarësh, duke i ridrejtuar këto para drejt vendeve me orientim konservator në Amerikën Latine.

Teksa republikanët luftojnë për të ruajtur shumicën në Kongres në zgjedhjet e mesmandatit dhe vlerësimet e ulëta të Trump-it nuk po i ndihmojnë, është e qartë se Uashingtoni nuk do të ngurrojë t'u shkelë herë pas here në kallo edhe aleatëve të vet.

Jovana Djurovic është një gazetare me bazë në Uashington.

Opinionet e shprehura janë vetëm ato të autores dhe jo domosdoshmërisht pasqyrojnë pikëpamjet e BIRN.

Etiketa: Aleksandër Vuçiç Ballikani Donald Trump Edi Rama Hashim Thaçi
Jared Kushner Kosova Milorad Dodik Ratko Mladić Richard Grenell Serbia SHBA
UCK

[Opinion](#)
[Reportazhe](#)
[Analiza](#)
[Investigime](#)
[Lajme](#)
[Blog](#)
[Rajoni](#)

[Rreth nesh](#)
[Stafi](#)
[Kontakttoni](#)
[Ankesa dhe Korrigjime](#)
[Politika e privatësisë dhe
rregulla të tjera](#)
[Letra për redaktorin](#)

Follow Us



Të gjitha të drejtat janë të rezervuara

© 2014 - 2026 Reporter.al - BIRN

Dev by [Sfida.PRO](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.